



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e dates 4 qershor 2008, nenit 12 të Rregullores për varrezat ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave 15Nr.011-71870 e datës 27.11.2018, nenit 27 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve 15Nr.011-70915 e datës 28.12.2016, si dhe neneve 9 dhe 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e 27. 11. 2018, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

V E N D I M
PËR PËRCAKTIMIN E SHUMËS PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR
MBULIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

Me këtë Vendim **përcaktohet** që shuma për kryerjen e shërbimeve të Varrimit për qytetarët e Komunës së Lipjanit të jetë **170 €** për një varrim

Neni 2

1.Kjo shumë e mjeteve do të transferohet në xhirollogarinë bankare të anëtarit të familjes së ngushtë të të ndjerit/es, i cili familjar duhet të parashtojë kërkesë në Komunë brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e vdekjes.

2 .Procedurat rreth shërbimeve të varrimit, parashtrimin të kërkesës dhe dokumentacionit që duhet ti bashkëngjitet kërkesës janë të përcaktuara me dispozitat e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave 15Nr.011-71870 e datës; 27.11.2018.

Neni 3

Mjetet financiare për mbulimin e shërbimeve të varrimit do të paguhet nga buxheti i Komunës përkatësisht nga kategoria ekonomike e subvencioneve.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës dhe fillon të zbatohet nga data 01.01.2019.

Prej datës 01.01.2019 përkatësisht fillimit të zbatimit të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për përcaktimin e shumës për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan për mbulimin e shpenzimeve të varrimit 15Nr.400-45612 i datës 12.11.2014.

15Nr. 400-71876

Lipjan, më 27. 11. 2018

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi

